



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 41.

Prishtinë, 6.04.2016.në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim

Në mbledhje morrën pjesë: Jasmina Živković, Saša Milosavljević, Agim Kikaj, Čerim Bajrami, Mufera Sinik, Veton Berisha, Slavko Simić dhe Milka Vuletić.

Munguan: Agim Çeku, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha dhe Danush Ademi.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja, Këshilli konsultativ për komunitete, Qendra humane nga Mitrovica PAI (Platforma për analizë dhe hulumtime)

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi : Jasmina Živković, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar dhe miratuar ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i drejtorit të Zyrës për Komunitete lidhur me implementimin e strategjive të Qeverisë që kanë të bëjnë me komunitetet.**

I ftuar: Drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, Ivan Tomiq.

Jasmina Živković, kryetare, hapi mbledhjen e sotme të komisionit, duke përshëndetur përgjigjen e drejtorit për të raportuar para komisionit lidhur me zbatimin e strategjive qeveritare të cilat merren me komunitetet. Theksoi që strategjitë rregullojnë çështje të rëndësishme, dhe njëra prej atyre çështjeve është problematika e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në organet e administratës publike, në nivel qendror dhe lokal, dhe se, tani për tani, nuk respektohet dhe nuk zbatohet neni 11 nga ana e institucioneve të pushtetit, i cili rregullon kuotat minimale dhe maksimale në një përqindje bazike për 10%, vendet e rezervuara të cilët ju takojnë komuniteteve.

Kërkojë sqarime lidhur me zgjidhjen e çështjes së nostrifikimit të diplomave, do të thotë se a është kompetente Zyra për këtë problematikë, si dhe çështje të pavarësisë financiare të kësaj Zyre.

Veton Berisha, theksoi që njëra prej kompetencave të Zyrës për çështjet e komuniteteve është që të merret me punën e komuniteteve në terren, përmirësimin e kushteve jetësore në aspektin ekonomik dhe social, si dhe kërkojë përgjigje dhe sqarime lidhur me kërkesën e komunitetit Egjiptian për ndërtimin e 14 shtëpive familjare, pastaj për vlerën e suficitit të kësaj Zyre, si dhe cilët janë kriteret për ndarjen e buxhetit, cili është investimi më i madh kapital dhe pse janë vetëm 6 studentë nga komuniteti Egjiptian ata të cilët janë pranuar si praktikant në institucionet publike në raport me 49 studentë nga komuniteti serb.

MuferaSinik, theksoi se shqetësuese për te është neni 11, i Ligjit për shërbimin civilë, i cili rregullon përqindjen e të punësuarave në administratë publike nga rradha e pjesëtarëve të komunitetit pakicë, dhe deri më tani sa është zbatuar kuota në institucionet publike.

Pastaj, cila është shuma e mjeteve buxhetore për mbështetjen e manifestimit të datës 23 prill, dita e komunitetit turk, dhe niveli i zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Ćerim Bajrami, si çështje thelbësore, ai paraqiti pyetjen lidhur me menagjimin e buxhetit të përgjithshëm të Zyrës dhe mënyrën e ndarjes së mjeteve buxhetore për të gjitha komunitetet.

Saša Milosavljević, kërkojë sqarime në lidhje me procedurën e verifikimit të diplomave për studentët e Universitetit të Prishtinës me seli në Mitrovicë, cila është situata lidhur me Programin për zhvillimin e bujqësisë (kriteret dhe qytetet e përzgjedhura) si dhe çështja e zëvendësimit të Zyrës.

Përgjigjet dhe sugjerimet në pyetjet e parashtruara

Ivan Tomić – drejtor i Zyrës: sigurisht e keni të ditur se jam emëruar në funksionin e drejtorit të Zyrës për çështjet e komuniteteve nga data 1. Shtator 2015. Zyra ka kaluar shumë kohë pa drejtor çka ka kontribuar në frenimin e shumë proceseve të rëndësishme që kanë ndikuar në vet rezultatet e punës për vitin 2015.

Buxheti i Zyrës për çështjet e komuniteteve është, njëkohësisht, edhe buxhet për kryeministrin me të cilin ai disponon, dhe për të cilin ka të drejtë ta shfrytëzojë, çdo herë kur ekziston një nevojë e tillë.

Që nga fillimi i punës, jam munduar që të analizojë gjendjen momentale faktike, por edhe të tentojë që të bëjë diçka më shumë për kohën e limituar të cilën e kisha në atë vit. Ishte shumë vonë që të iniciohet ndonjë projekt i rëndësishëm infrastrukturor dhe të fillohet me një punë më serioze për të ndihmuar komunitetet. Çdo gjë që vije deri te zyra ime, duhet të kalojë edhe nëpër një seri të zyrave të tjera, në mënyrë që kërkesa të miratohet edhe të paguhet.

Pas miratimit nga unë, është e domosdoshme që të nënshkruhet nga ana e shefit të Kabinetit të kryeministrit, pastaj të kalojë përmes zyrës së sekretarit gjeneral, Zyrës ligjore, vetë kryeministrit, por edhe zyrës për buxhet dhe financa, dhe në fund është e nevojshme të ketë edhe tri nënshkrime. Për shkak se kryeministri shpesh herë është i zënë me punë, për nënshkrimin final, pas nënshkrimit tim, të shefit të Kabinetit, të Zyrës ligjore dhe Zyrës së sekretariatit, është e domosdoshme që nënshkrimin ta vendos edhe zëvendësi i kryeministrit dhe, më në fund, edhe Zyra për buxhet dhe financa.

Për shkak të afateve kohore nuk është lejuar shpallja e konkursit për mbështetje të mediave dhe organizatave joqeveritare, që ka shkaktuar edhe formimin e një komisioni intern, i cili ka shqyrtuar kërkesat që kanë arritur në Zyrë deri në atë kohë. Pasi që kërkesa do të kalonte nëpër komision, shefi i Kabinetit të kryeministrit, përmes të cilit do të kalonte çdo kërkesë, ai veç e veç do i shqyrtonte dhe do i procedonte më tutje sipas procedurës.

Sa i përket vet implementimit të strategjive qeveritare për komunitetet, Zyra vepron sipas mandatit, çka shihet edhe nga aktivitetet tona. Mërimi me punën e komuniteteve në teren, përmirësimin e kushteve për jetën e tyre, në kuptimin ekonomik dhe social, ofron mbështetje për organizatat joqeveritare dhe për media, që gjenden në komunitete si dhe kemi takime me partner ndërkombëtar, në mënyrë që të mbulohen të gjitha pjesët shoqërore.

Dera e zyrës ka qenë gjithmonë e hapur për të gjithë ata që vijnë aty, bile edhe pa paralajmërim, sepse mundohen që të mbajnë kontakt me të gjithë, në mënyrë që të i dëgjojë dhe të njoftohen me të gjitha problemet të cilat ndikojnë në komunitete, në mënyrë që të mundohemi edhe të gjejmë përgjigje adekuate për to.

Disa nga ju, që jeni sot këtu, janë bindur në këtë dhe se askush dhe asnjëherë nuk ka shkuar nga Zyra pa qenë i pranuar dhe i dëgjuar nga ana ime.

Kemi përtërirë kontaktet dhe vazhdojmë të bashkëpunojmë me organizata ndërkombëtare, institucione dhe ambasada, në mënyrë aktive. Rezultatet nga kjo do të jenë të dukshëm gjatë këtij viti sepse shpresojmë në ndërmarrje të përbashkëta në të gjitha nivelet, çka tregon edhe përkushtimi dhe kujdesi i bashkësisë ndërkombëtare, e cila përcjellë punën time, dhe e cila mundohet të na ofrojë mbështetje ku do që ajo është e nevojshme.

Me 05. Tetor 2015, zyra ka shpallur konkurs për praktikantë në institucionet publike në nivel qendror dhe lokal për studentët e diplomuar nga përkatësia e komuniteteve jo shumicë.

Në bazë të Vendimit nr. 2009/2015, të sekretarit permanent, është formuar komisioni pesë anëtarësh. Intervistimi ka filluar me datën 01.12.2015 dhe ka vazhduar deri më 24.12.2015. Në konkurs janë paraqitur 805 kandidatë. Projekti është për gjashtë muaj, dhe se praktikantët e pranuar fitojnë nga 150 €.

Janë pranuar 14 Boshnjakë, 9 nga komuniteti Turk, 7 nga komuniteti Rom, 6 nga komuniteti Ashkali, 6 nga komuniteti Egjiptian, 4 nga komuniteti Goran, dhe 5 Shqiptarë, si dhe 49 nga komuniteti Serb.

Sa i përket arsimimit në AUK, kemi 7 studentë të përkatësive jo shumicë, të cilët marrin bursa nga Zyra e jonë. Kemi ndihmuar dhe vazhdojmë të ndihmojmë studentët nga të gjitha komunitetet, për aq sa ne kemi mundësi.

Nga shtatori deri në dhjetor, kamë punuar intenzivisht në Rregulloren për verifikimin e diplomave për studentët e Universitetit të Prishtinës me seli në Mitrovicë. Këtë proces, në vitin 2013, e kishte filluar Zyra për çështjet e komuniteteve në bashkëpunim me ambasadat e Britanisë dhe Norvegjisë. Këtu kemi të bëjmë me zgjidhjen e çështjes teknike në terren, në mënyrë që menjëherë të iu mundësohet të diplomuarave nga ky universitet që të aplikojnë për punë në institucionet publike në Kosovë.

Krahas problemeve të shumta dhe opstrukcioneve në vet procesin, mburrem që kemi arritur të nxjerrim Rregulloren, e cila është miratuar në fund të muajit dhjetor. Është formuar Komisioni i pavarur, është përzgjedhur organizata joqeveritare ndërkombëtare e cila do të vendos komunikimin me Universitetin, si dhe erdhi deri te hapat për të formuar Zyre në Mitrovicë dhe Graçanicë.

Duke marrë parasysh marrëveshjen e arritur në Bruksel, mbetet vetëm të shohim se a do të implementimet kjo në terren por, gjithsesi, do të ishte ideale që kjo çështje, përfundimisht, të zgjidhet në mënyrë permanente në nivel më të lartë, sepse, rregullorja, si e tillë, ka vetëm status të përkohshëm, për deri sa Beogradi dhe Prishtina të mos dakordohen.

E dini edhe vetë se 10% të përfaqësimit të komuniteteve në institucione, që është paraparë me ligj dhe nuk është respektuar, ndërsa me këtë proces tani kemi mundësi që t'i lëmë anash arsyetimet për mospranimin e diplomave dhe me angazhim të përbashkët të gjejmë dhe krijojmë vende pune.

Më herët kemi mundur të punësojmë njerëz nga përkatësitë e komuniteteve si portare, shoferë, zyrtarë administrativ, ndërsa tani kemi mundësi të kërkojmë vende udhëheqëse në të gjitha institucionet me kënaqësi do t'ju informojë për hapat e mëtejme dhe shpresojë në punën e përbashkët për këtë çështje.

Zyra është anëtare e Grupit punues për strategjinë për Rom, Ashkali dhe Egjiptian, dhe se jemi të njoftuar që komuniteti Egjiptian dëshiron të jetë jashtë kësaj strategjie. Partnerët tanë të huaj, disa herë, e kanë potencuar se dëshirojnë që mua Zyra për çështjet e komuniteteve të merr rolin udhëheqës në implementimin e strategjisë, në mënyrë që të sigurojë sukses më të madh në krahasim me atë të mëparshmen.

Në përputhje me këtë insistojmë që ne të jemi mekanizëm për implementim dhe kërkojmë që të sigurohen mjetet në mënyrë që të punësojmë njerëz nga ato komunitete, të cilët aktivisht do të merreshin me çështjen brenda kornizave të Zyrës për çështjet e komuniteteve.

Hapi tjetër, nga ana jonë, do të jetë studimi mbi përfaqësimin e komuniteteve në institucionet publike, për çka kemi mbështetjen e ambasadës amerikane, norvegjeze dhe britanike, dhe shpresoj që deri në qershor të këtij viti ky studim do të jetë i gatshëm.

Në bisedimet me ambasadën amerikane erdhi deri te përfundimi që është e nevojshme që të punohet diçka edhe për çështjen e pranimi të listave të kurorëzimit dhe nxjerrjes së dokumentacionit, për çka zyra, dalëngadalë, po ballafaqohet drejtpërsëdrejti edhe me këto probleme

Zyra ka nënshkruar marrëveshje me komunën e Pejës, në vlerë prej 30.000 €, për dy projekte: vendosja e instalimeve – kamera të sigurimit në fshatin Gorazhdecë, dhe projekti i dytë rregullimi i gropave septike në fshatin Leshan, në vendet ku janë të banuara me lagjet e komuniteteve Rome, Ashkalive dhe Egjiptian.

Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me komunën e Novobërdës në shumë prej 64 mijë € për ndërtimin e hallës sportive.

Kemi nënshkruar memorandum me komunën e Rahovecit për rregullimin e shtratit të lumit dhe qendrës në fshatin Hoqa e Madhe.

Kemi nënshkruar memorandum me IOM, në vlerë prej 30 mijë €, për fshatin Naklle, lidhur me ndërtimin e rrugës dhe ndriçimin publik në lagjen rome.

Në periudhën e ardhshme, së bashku me IOM dhe USAID, si dhe me disa ministri, do të nënshkruajmë memorandume për ndërtimin e aneksit të shkollës multi-etnike në fshatin Plemetin, rekonstruktimin e shtëpisë së kulturës në fshatin Prilluzhë, pajisjen e shkollës në Istog, Kamenicë, Klllokot, rekonstruktimin e shtëpisë së kulturës dhe rregullimin e shtratit të lumit në fshatin Gorazhdec, por kanë filluar bisedimet me partnerët edhe për projekte të tilla, të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme për të gjitha komunitetet.

Këtë vit planifikojmë të shpenzojmë afro gjysmë milioni € për projekte infrastrukturore.

Vitin e kaluar është formuar “grupi ndërministror për çështje të komuniteteve”. Grupi ndërministror, i cili merret me komunitetet, dhe anëtarët i të cilit jam edhe unë krahas zëvendës kryeministrit Branimir Stojanović, ministri Marić, ministri Jeftić si dhe ministra të tjerë nga komunitetet joshumicë, por edhe ministrive të cilat janë të një rëndësie thelbësore për komunitetet, do të merren me çështjet e sigurisë, përdorimin e gjuhëve, përfaqësimin e komuniteteve në institucionet publike, me çështjet bujqësore si dhe me pronën e uzurpuar.

Vendimet dhe rekomandimet, të cilat do i nxjerrë komisioni, kanë një rëndësi dhe peshë sikur të ishin të nxjerra në takimet e Qeverisë, dhe mendoj që përmes këtij mekanizmi do të arrijmë të përmirësojmë situatën në këto lëmi, por edhe në vetë zbatimin e Ligjit për komunitetet, dhe që do të kontribuojë në promovimin e bashkëjetesës dhe përmirësimin e të drejtave të komuniteteve në terren.

Zyra, gjithashtu, kryeson me CIG-in (*Community Issue Group*), të cilin e përbëjnë, në shumicë, institucionet ndërkombëtare të cilat i informojmë dhe më të cilat bisedojmë lidhur me problemet e komuniteteve. Këto takime mbahen një herë në muaj.

Për veriun e Kosovës kemi pasur të hapur një konkurs ku është përzgjedhur OJQ – AKTIV, dhe kanë fituar grantin prej 88 mijë € (kjo është bërë në bashkëpunim me ambasadën e Norvegjisë).

Akoma nuk kemi filluar në ndërtimin e shtëpive. Së shpejti do të fillojmë me shqyrtimin e atyre kërkesave (në bashkëpunim me Kabinetin, në fund të vitit të kaluar, është lejuar ndërtimi i dy shtëpive për pjesëtarët e komunitetit Egjiptian, ku Zyra merr pjesë vetëm me një shumë minimale të parave, ndërsa të tjerët do të jenë të ndara nga ana e komunës).

Këtu duhet të theksojë se janë miratuar dy, nga gjithsejtë sa më duket 14 kërkesa, por jo për shkak të pengesave nga ana e Zyrës por nga ana e Kabinetit të Kryeministrit. Edhe një herë e theksojë që Zyra nuk funksionon pavarësisht, sepse ne nuk jemi ministri por jemi pjesë e Kabinetit të Kryeministrit, pa lejen e të cilit asgjë nuk mund të fillohet për procedim të mëtutjeshëm.

Kemi mbështetur ditët e komuniteteve me 20 deri në 25 mijë €, nga shtatori deri në fund të vitit të kaluar, dhe një praktikë të tillë do e vazhdojmë edhe këtë vit.

Zyra, çdo vite, organizon tryeze të rumbullakët me rastin e manifestimeve të ditëve të komuniteteve joshumicë, dhe krahas kësaj bënë ndarjen edhe të një shume të caktuar parash.

Këtë vit, për manifestimin e Ditës ndërkombëtare të Romëve, do të ndajmë 20.000 €, ku ata, brenda asaj shume, do mbështesin OJQ të cilat ne do i rekomandojmë në bazë të kërkesave të cilat kanë arritur, duke u munduar që të mbulojmë, gjeografikisht, sa më shumë rajone.

Kemi mbështetur Ditën e komunitetit Ashkali.

23 prilli është Dita e komunitetit Turk, dhe këtë ditë do e mbështesim dhe të vazhdojmë me praktikën e njëjtë edhe në rastet e komuniteteve tjera ku, me të vërtetë, mundohemi që të mbështesim sa më shumë organizime.

Zyra nuk mund të financojë të gjitha kërkesat, krahas asaj që ekzistojnë një numër i madhe i kërkesave ekzistojnë edhe eprocedura të caktuara në Zyrën e kryeministrit, të cilat gjithmonë duhet respektuar prandaj ndodhë që edhe pagesat të vonohen.

Një bashkëpunim me Kabinetin e zëvendës kryeministrit dhe UNDP, kemi hapur konkurs për mbështetjen e komunave, në mënyrë që të ju huazojmë ekspert për hartimin e projekt dokumenteve për të konkurruar në fondet ndërkombëtare.

Konkursi për mbështetjen e mediave është mbyllur dje, me një fond prej 200 mijë €, ndërsa konkursi për mbështetjen e organizatave joqeveritare do të jetë i hapur qyshe nesër, me një fonde prej 100 mijë €. Njëra prej rekomandimeve, nga ana ime, për komisionin do të jetë që disi të ndahen mjete në mënyrë që të gjitha komunitetet të kenë përfitime nga ky konkurs por, natyrisht, kjo do të varet edhe nga vetë kualiteti i projekteve të cilët do të na arrijnë.

Në bashkëpunim me UNDP kemi hapur konkurs për mbështetjen e familjeve të cilët merren me veprimtari bujqësore. Ky konkurs është shpallur në komunat Obiliq, Vushtri, Graçanicë, Novobërdë, Gjiilan dhe Klinë. Duhet të theksoj që me këtë rast UNDP ka marrë parasysh të gjitha mjetet të cilat, për programe të ngjashme, shkojnë apo të cilat janë dhënë me herët në komuna tjera, dhe sipas rekomandimit të tyre ne kemi përcaktuar që këto komuna të jenë shfrytëzuese të kësaj runde për të cilën janë ndarë 75 mijë €.

Pas kësaj runde, shpresoj që nga muaji qershor të fillojmë me tregim të suksesshëm dhe të gjejmë donatorë në mënyrë që të publikojmë të njëjtin apo një thirrje të ngjashme edhe në disa komuna tjera në të cilat jetojnë një numër i konsiderueshëm i komuniteteve.

Duke marrë parasysh edhe Programin për komunitete, i cili është votuar në Kuvend lidhur me ndarjen e buxhetit për Zyrën për çështjet e komuniteteve dhe Ministrinë për komunitete dhe kthim, Zyra ime këtë e ka marrë në shqyrtim serioz por akoma presim Zyrën ligjore, me të cilën punojmë në Projekt programin për komunitete, i cili definon mënyrën e financimit si dhe vetë mënyrën e ndarjes së mjeteve.

Drafti i parë së shpejti do të jetë i përfunduar, por vetë forma dhe ajo që do të përmbajë me shkrim do varet nga zyra jonë ligjore, në mënyrë që të jemi të sigurtë që zyra i bënë të gjitha sipas normave ligjore. Kemi mbajtur edhe punëtorinë në Prizren me anëtarët e Grupit punues, muajin e kaluar, ku është bërë një përparim i konsiderueshëm lidhur me këtë çështje.

Natyrisht, un do të dëshiroja që gjithë këtë punë që bënë zyra të shkonte më shpejtë, por duhet respektuar procedurat si dhe afatet ligjore të cilat kanë të bëjnë me zyrat kompetente. Jam mirënjohës Zyrës ligjore por edhe Zyrës për buxhet dhe financa të cilat përkujdesen për çdo kërkesë që duhet të kalojë nëpër procedura të caktuara, deri sa ti zotojnë mjetet financiare – paratë. Kjo do të thotë se asnjë kërkesë nuk mund të kalojë nëse nuk është sipas kodeve buxhetore, dhe ka ndodhur që të na kthehen kërkesat mu për shkak të kësaj arsyeje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Jasmina Živković